



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Bulevardi "Zogu I", Tiranë

Tel: +3554 2259817 Fax: +3554 2259822

Nr. 305 Prot.,

Tiranë më 24.01.2019

LËNDA: Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe buxhetin përkatës.

KUVENDIT TË SHQIPËRISË

ZOTIT ULSI MANJA

**KRYETARI I KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN
PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

TIRANË

I nderuar zoti Manja,

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e Kuvendit të Republikës si dhe të Komisionit që ju drejtoni, siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor në vijim ushtrimit të veprimtarisë së tij mbështetur në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", miratoi me vendimin nr.12, datë 18.01.2019, strukturën organizative të funksionimit të tij.

Sa më sipër, bazuar në parashikimet e ligjit për buxhetin e vitit 2019 lutemi, miratimin nga ana juaj, të numrit të përgjithshëm të punonjësve, sipas strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe buxhetit përkatës, sipas materialeve bashkëlidhur kësaj shkrese.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KRYETARE

NAURED A LLAGAMI